



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**SHPALLJE PËR NËPUNËS CIVIL
NGRITJE NË DETYRË**

Kontrolli i Lartë i Shtetit hap procedurat për plotësimin e **1 (një) vendi vakant “Përgjegjës i Sektorit të Financës”**.

I. Kërkesat e përgjithshme

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme si më poshtë:

- të jenë shtetas shqiptar;
- të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- të zotërojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- të jenë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- ndaj tij/saj të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit.

II. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati dhe kriteret e veçanta

Kandidatët që aplikojnë për këtë vend pune duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të jenë diplomuar jo më poshtë se niveli Master Shkencor në Financë;
- Të kenë përvojë pune në fushën e diplomimit minimumi 5 vjet;
- Të jenë nëpunës civil në kategorinë III.
- Të zotërojnë kualifikime që lidhen me fushën profesionale;
- Të kenë njohuri të gjuhës angleze;
- Të kenë aftësi të mira drejtuese, komunikuese dhe bashkëpunuese.

Kategoria e pagës për këtë vend pune është II-2.

III. Përshkrimi i punës për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Financës”

1. Kryen detyrat e përcaktuara si nëpunës zbatues, sikundër përcaktohet në kuadrin ligjor për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
2. Përgatit dokumentet përfundimtare të buxhetit dhe bashkërendon punën gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit.
3. Përgatit dokumentet e monitorimit të buxhetit të institucionit.
4. Identifikon dhe krijon regjistrin e riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve për arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të sektorit.
5. Garanton para miratimit të shkresave/urdrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të economicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit.
6. Dokumenton të gjitha transaksionet financiare dhe të tjera dhe garanton gjurmën e auditimit.
7. Mban sistemin e kontabilitetit, raportimit periodik për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë, në përputhje me rregullat e miratuara.

8. Kryen rakordimin mujor të shpenzimeve me Degën e Thesarit, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
9. Ndjek procesin e inventarizimit të pasurisë së institucionit, bën sistemimet përkatëse për diferencat apo dëmtimet duke nxjerrë edhe përgjegjësitë përkatëse.
10. Ruan dhe mbron aktivet dhe dokumentacionin e njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar.
11. Siguron mbledhjen e të gjitha borxheve të pa arkëtuara dhe në rastet kur nuk është i mundur të mblidhet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligje të veçanta.
12. Në kuadër të përmbushjes së detyrave të ngarkuara me ligj, mban marrëdhëniet me Zyrën e Tatim Taksave.
13. Dorëzon pranë Sektorit të Protokoll-Arkivit në formë elektronike të gjithë databazën vjetore të të dhënave të krijuara nga Sektori i Financës, përgjatë periudhës ushtrimore.
14. Azhurnohet me ndryshimet në legjislacion që prekin fushën e përgjegjësisë së sektorit të financës dhe sferën e detyrave të ngarkuara.
15. Garanton që të gjithë kreditorët të paguhen në kohë.
16. Etj.

IV. Paraqitja e dokumenteve

Kandidatët që shprehin interesin për të aplikuar duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në KLSH:

- Kërkesë;
- Jetëshkrimin e përditësuar;
- Fotokopje të noterizuar të diplomës së bashku me listën e notave;
- Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht sipas legjislacionit në fuqi për njehsimin e diplomave;
- Fotokopje e librezës së punës ose vërtetim për bazën e vlerësuar, për të vërtetuar eksperiencën në punë;
- Fotokopje të letërnjoftimit;
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim që nuk kanë masë disiplinore në fuqi;
- Dy vlerësimet e fundit të performancës në punë;
- Çdo dokument tjetër që vërteton njohuritë e gjuhës së huaj, trajnimeve, kualifikimeve arsim shtesë si dhe vlerësime pozitive të përmendura në jetëshkrim.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet brenda datës 08.11.2024.

V. Faza e verifikimit paraprak

Në faqen zyrtare të KLSH-së www.klsh.org.al më datë **12.11.2024** do të bëhet shpallja e listës së verifikimit paraprak për kandidatët që plotësojnë kriteret e shpallura të vendit të punës. Kandidatët që nuk do të kualifikohen do të njoftohen me email po në të njëjtën ditë. Njoftimi do të dërgohet për publikim edhe në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

VI. Konkurrimi

Kandidatët do të vlerësohen me shkrim mbi njohuritë në lidhje me:

- Strategjinë e Zhvillimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligjin nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;
- Legjislacionin për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Legjislacionin për hartimin dhe monitorimin e buxhetit;
- Legjislacionin dhe standardet për kontabilitetin publik;
- Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të KLSH-së;
- Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së;
- Kodin Etik të KLSH-së.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen lidhur me:

- Njohuritë, aftësitë dhe kompetencën lidhur me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Zbatimin e kuadrit rregullativ në funksion të pozicionit në KLSH;
- Eksperiencat e tyre të mëparshme lidhur me pozicionin e punës;
- Vizioni, motivimi dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

VII. Fazat dhe mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do t’i nënshtrohen fazave të vlerësimit si, verifikimi paraprak dhe vlerësimi i kandidatëve. Verifikimi paraprak, ka për qëllim të verifikojë nëse kandidatët plotësojnë kriteret e përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Vlerësimi i kandidatëve, përfshin:

- a) vlerësimi i dokumentacionit (arsimimi, përvoja, trajnime të lidhura me fushën);
- b) vlerësimi me shkrim;
- c) intervista e strukturuar me gojë.

Në përfundim të procesit të vlerësimit vetëm kandidatët që do të grumbullojnë të paktën 70% të pikëve totale do të shpallen fitues.

VIII. Njoftimi i kandidatëve

Në faqen zyrtare të KLSH-së, www.klsh.org.al më datë **12.11.2024** do të bëhet shpallja e listës së verifikimit paraprak, si dhe datat mbi zhvillimin e testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar. Kandidatët që nuk do të kualifikohen do të njoftohen me email. Njoftimi do të dërgohet për publikim edhe në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

Konkurrimi është i hapur për nëpunësit civil që plotësojnë kriteret e veçanta të shpallura.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT